



Komuna e Obiliqit - Opština Obilić - Municipality Obiliq

SHMLP "ISMAIL DUMOSHI" dhe GJIMNAZI "17 SHKURTI"

Datë: 22.04.2026

Nr i protokollit: 219

RISHPALLJE-FTESË PËR OFERTË

SHMLP "Ismail Dumoshi"-Obiliq dhe Gjimnazi "17 Shkurti" bazuar në UA 02/2016 për akrivitete jashtëshkollore, organizon ekskursion 3 buajtje dhe 4 ditë për në Shqipëri për 85 nxënës të SHMLP „Ismail Dumoshi” dhe 59 nxënës të Gjimnazit "17 Shkurti" të klasëve përfundimtare (maturant).

Ekskursioni planifikohet të realizohet ndaras për secilen shkollë, ndërsa çmimi, hoteli dhe itinerari janë të njëjta për dy shkollat.

Ekskursioni planifikohet:

Për Gjimnazin "17 Shkurti" nga data 13.05.2026 deri me 16.05.2026.

Për SHMLP "Ismail Dumoshi" nga data 06.05.2026 deri me 09.05.2026.

- Dita e parë, Obiliq- Prizren –Krujë- Durrës(Akomodimi në hotel)
- Dita e dytë, Durrës-Berat (Monumentet Historike)
- Dita e tretë, Durrës-Vlorë (Shtëpia e Pavarësisë, Monumentet historike)
- Dita e katërt, Durrës-Tiranë -Lezhë (vizitë varrit të Skënderbeut) nisja për Kosovë.

Në ofertë duhet të paraqitet itinerarin e paraparë, çmimi për nxënës duke përfshirë të gjitha pagesat për nxënës për hyrje në muze në Kalanë e Krujës, Varrin e Skenderbeut në Lezhë, Shtëpinë e Pavarësisë në Vlorë dhe Kalanë e Beratit, hoteli, racionet (mëngjes,drekë dhe darkë) dhe menyuja e ushqimit.

Të drejtë pjesmarrje në ofertë kanë të gjitha agjencionet që plotësojnë këto kushte të përgjithshme :

- Licencën e Agjencionit (turizëm ndërkombtar)
- Certifikatë e biznesit dhe informatori kompanise
- Numri fiskal
- Vërtetim i ATK-së që kompania nuk ka obligime tatimore
- Referenca për punët e kryera në lidhje me këtë veprimtari (të ketë referencë pozitive)
- T'i ketë dëshmi me afat që ka kryer procedurat e kontrollimit teknik (dëshmi me shkrim).
- Numrin e mjaftueshëm të Autobusëve (të ketë dëshmi)
- Certifikatë mbi gjendjen shëndetësore të shoferëve të autobusëve
- Kontratat e punës dhe vërtetimin e ATK-së për vozitës
- Autobusët duhet të janë komfor dhe me klimë.
- Të siguroj përkujdesje mjekësore (certifikatë pune dhe diplomë të mjekut).
- Marrëveshjen me hotelin për shërbimet e ofruara dhe sigurinë.

Dorëzimi: Oferta e përpiluar në formë të kërkuar duhet të vendoset në pliko të mbyllur dhe të vulosur nga ana e ofertuesit, si dhe të shkruhet qartë Oferta për Ekskursion për maturantët e shkollave të mesme në Obiliq.

Ofertat dorëzohen në Drejtorin e Arsimit në Obiliq deri më: **29.04.2026 në ora 10.00.**

Hapja e ofertave: Hapja e ofertave do të bëhet më: **29.04.2026, në ora 11:00** në Drejtorinë e Arsimit në Obiliq.

Tahir Morina Ud.Drejtor

MSc Besa Gashi Drejtore